



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

**V E N D I M**

**Nr. 36 , Datë 26 / 01 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe bazuar në Urdhërin nr.161, datë 03.11.2015<sup>1</sup>, filloi procedurën e shqyrtimit kryesisht të çështjes.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve.**

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar<sup>2</sup> informon Komisionerin se: *“Gjatë zhvillimit të punës së organizatës, janë informuar, që banesat sociale të ndërtuara në zonën e Shkozës, janë të papërshtatshme për përdorim nga ana e PAK. PAK kanë aplikuar ndër vite në programin e strehimit pranë Bashkisë Tiranë por vetëm së fundmi kanë arritur që të përfitojnë banesa sociale. Personat me aftësi të kufizuar përfaqësojnë një ndër grupet prioritare për të përfituar banesa sociale me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës, papërshtatshmëria e këtyre ambienteve sjell cënimin e kësaj të drejte dhe diskriminimin e tyre. Mungesa e përshtatshmërisë së këtyre ndërtesave në përputhje me kriteret e parashikuara në VKM nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”” ka sjellë mungesë aksesit për t’u shfrytëzuar nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe për rrjedhojë mohim të së drejtës për t’u strehuar në kushte të barabarta me të tjerët. Banesat të cilat iu ofrohen PAK, ndodhen minimalisht në katin e dytë të*

---

<sup>1</sup> Urdhër nr.161, datë 03.11.2015 “Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes në lidhje me përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale të Bashkisë Tiranë për personat me aftësi të kufizuar”.

<sup>2</sup>Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën FSHDPAK.

*këtyre ndërtesave dhe e vetmja mënyrë aksesi janë shkallët. Referuar VKM-së sipërcituar duhet që në këto banesa të ndërtohet ashensor sipas parametrave të përcaktuar në rregullore ose të gjenden zgjidhje të tjera më pak të kushtueshme. Krijimi i mundësisë për jetesë të pavarur dhe autonome si të gjithë qytetarët e tjerë dhe për personat me aftësi të kufizuara, është një e drejtë themelore dhe garanci për të mundësuar pjesëmarrjen e barabartë në shoqëri. Banesat duhet që të jenë të sigurta dhe të aksesueshme nga i gjithë komuniteti. Përshtatja e këtyre banesave nuk është vetëm një detyrim ligjor por dhe detyrim në interes të komunitetit. Shteti Shqiptar ka ratifikuar Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, e cila vendos detyrimin e shtetit për të siguruar strehim të përshtatshëm dhe mundësi për të marrë pjesë efektivisht në programet e strehimit”.*

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimoreose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, **aftësinë e kufizuar**, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.928 prot, datë 11.12.2015 ju kërkua informacion Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, lidhur me pretendimin e ngritur nga FSHDPAK.
2. Në mungesë të përgjigjes nga ana e Bashkisë së Tiranës, me shkresën me nr.928/1 prot., datë 17.12.2015, Komisioneri iu drejtua rishtaz, lidhur me dërgimin e informacionit për sa sipër.
3. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 01.02.2016<sup>3</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kreu një inspektim pranë Bashkisë Tiranë.

---

<sup>3</sup> Në zbatim të Urdhërit nr.14, datë 28.01.2016, të Komisionerit.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Drejtoreshen e Përgjithshme të Shërbimit Social, pranë Bashkisë Tiranë, znj.Besjana Mehmetaj, e cila kërkoi një kohë të arsyeshme për përgatitjen e informacionit të kërkuar nga Komisioneri, për të cilën u ra dakort që të dërgohej shkresërisht.

4. Duke qenë se, për verifikimin e të gjitha fakteve Komisioneri vlerësoi si të domosdoshëm marrjen e informacionit nga ana e Bashkisë, lidhur me këtë fakt, me Vendimin nr.28, datë 08.02.2016, vendosi pezullimin e procedimit administrativ<sup>4</sup>, me qëllim marrjen e të gjitha informacioneve të nevojshme.

Me shkresën me nr.2891/2 prot., datë 12.02.2016, Bashkia Tiranë informon Komisionerin, se: *“...Një ndër iniciativat e para, të ndërmarra pas konstituimit të Bashkisë Tiranë në Korrik të vitit 2015, ka qenë procesi i shpërndarjes së 242 banesave sociale me qira, për kategoritë e përmendur në ligjin nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i azhurnuar me ligjin nr.9719, datë 23.04.2007”, ku përfitues kanë qenë edhe familje me anëtarë me aftësi të kufizuara”.*

Gjithashtu, Bashkia ka informuar se, përsa i përket përshtatshmërisë dhe aksesueshmërisë, banesat sociale me qira janë ndërtuar në vitin 2007 dhe nuk ishin të parashikuara kushtet për shfrytëzimin e tyre nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Kjo pasi, VKM nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””, është miratuar një vit më vonë nga ndërtimi i banesave sociale.

Në përfundim ka konfirmuar se: *“Familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara, do të aksesohen nga programi i bonusit të strehimit, ku Bashkia Tiranë do të marrë përsipër pagesën e qirasë së apartamenteve të tyre, që janë të përshtatshme dhe të aksesueshme për banim”.*

### **III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

---

<sup>4</sup> Në zbatim të nenit 85, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative.

Përsa më sipër, Komisioneri analizoi situatën e sjellë në vëmendje nga FSHDPAK, parë kjo në respektim të zbatimit të Kushtetutës së R.SH, Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, si dhe legjislacionit.

Kështu, Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqet e parashikuar në të...”*

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar<sup>5</sup> është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.

Konventa ka përcaktuar se: *“Diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar” do të thotë që çdo dallim, përjashtim apo kufizim me bazë aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në dëmtimin apo anulimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Ky përkufizim përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e akomodimit të arsyeshëm”*.

Sipas interpretimit që bën Konventa, *“Akomodim i arsyeshëm” do të thotë modifikime të nevojshme dhe të përshtatshme duke mos imponuar një barrë dispropocionale, kur është e nevojshme në raste të veçanta, për t’i siguruar personave me aftësi të kufizuar gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët”*.

---

<sup>5</sup>Shqipëria me datë 15.11.2012, miratoi ligjin nr. 108/2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” dhe hyri në fuqi 11.02.2013.

Në nenin 9<sup>6</sup>, pika 1/a) parashikohet se: *“Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për akses, zbatohen ndër të tjera:*

- a) *Ndërtesa, rrugë, transport dhe lehtësira të tjera në ambjente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, **strehimin**, shërbimet mjekësore apo ambjentet e punës”.*

Shtetet Palë në këtë Konventë<sup>7</sup> garantojnë të drejtën e gëzimit në mënyrë të barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuar për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët. Është detyrim i këtyre Shteteve të marrin masat e duhura dhe efektive për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë në përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë dhe sigurimin e faktit se: *“...Personat me aftësi të kufizuar kanë akses në një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në: shtëpi, shërbime rezidenciale dhe shërbime në komunitet, dhe të parandalojë izolimin dhe veçimin nga komuniteti”.*

Të njëjtën frymë me Konventën përcjell edhe ligji nr.9232/2004 “Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane”, (i ndryshuar), i cili përcakton se duhet të trajtohen me përparësi familjet që kanë në përbërjen e tyre njëperson me aftësitë kufizuar.

Në kushtet kur personat me aftësi të kufizuar përfaqësojnë një ndër grupet prioritare për përfitimin e banesave sociale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës, papërshtatshmëria e këtyre ambjenteve sjell cënimin e kësaj të drejte dhe trajtim të pabarabartë me të tjerët në gëzimin e kësaj të drejte.

Infrastruktura e këtyre banesave është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për Shfrytëzimin e Hapësirave nga ana Personave me Aftësi të Kufizuar”.

Me miratimin e ligjit nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar” është cilësuar si objekt i tij:

---

<sup>6</sup>“Heqja e barrierave”

<sup>7</sup>Neni 19, “Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet”

- Përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët;
- Përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuar që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synim për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët.

Neni 3, i këtij ligji parashikon se: “*“Mohim i përshtatjes së arsyeshme<sup>8</sup>” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuar të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.*

Parim bazë i këtij ligji është mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuar të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë, në mënyrë që: “*t’u garantohet aksesueshmëri nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve<sup>9</sup>”.*

Në nenin 5, është parashikuar se, jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuar zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjtë me të tjerët, kur është nevojja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

**Kjo përfshirje e personave me aftësi të kufizuar duhet të jetë efikase dhe e barabartë në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale, mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, në mënyrë që të shmangë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe të rrisë mundësitë që këta persona të jenë të barabartë në gëzimin e këtyre të drejtave.**

Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.1074, datë 23.12.2015 “Për Përcaktimin e Masave së për Mënjanimin e Pengesave në Komunikim dhe Infrastruktura në Ofrimin e

<sup>8</sup>“Përshtatje e arsyeshme” është modifikimi dhe rregullimi i nevojshëm dhe i përshtatshëm, atëherë kur është i nevojshëm, pa vendosur barrë të tepruar, për t’u garantuar personave me aftësi të kufizuar gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe liritë themelore të njeriut.

<sup>9</sup>Neni 3, germa c).

Shërbimeve Publike për Personat me Aftësi të Kufizuar”, ka parashikuar masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuar.

Kështu, në pikën 3, të VKM-së sipërsctuar janë përcaktuar se, janë pengesa infrastrukturore:

- a) Pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përherëshme ose të përkohëshme;
- b) Pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse...

**Përsa më sipër, standartet e përshtatshmërisë duhen zbatuar në të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore ekzistuese si dhe në parqet, sheshet e rrugët ekzistuese, bazuar në kërkesat e parashikuara në kreun II, të këtij vendimi. Niveli i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar duhet garantuar në përputhje me kërkesat teknike, në çdo rast.**

Gjithashtu në pikën 2, kreu II, të këtij vendimi, parashikohet se: *“Çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.*

Gjithashtu me ligjin nr.73, datë 09.07.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 45 është përcaktuar se: *“1.Të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sipas dispozitave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar.3.Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun janë të detyruara të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre”.*

Në analizë të rastit të iniciuar kryesisht, Komisioneri, vlerëson se:

- Fakti se projekti i banesave sociale me qira<sup>10</sup> është hartuar në vitin 2007 dhe parashikimet e VKM-së “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”<sup>11</sup>, e po ashtu ligji 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar” dhe ligji nr.73, datë 09.07.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, janë miratuar pas vitit 2007, nuk e shkarkon Bashkinë nga detyrimi ligjor i parashikuar në ligjin nr.9232/2004 “Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane”, i cili ka përcaktuar zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike, si dhe përcakton se duhet të trajtohen me përparësi familjet që kanë në përbërjen e tyre një person me aftësi të kufizuar.

**Pra, këto akte të mësipërme ligjore dhe nënligjore përcaktojnë qartë detyrimin e autoriteteve përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun përmes detyrimit të tyre për të siguruar një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.**

Banesat të cilat u janë ofruar personave me aftësi të kufizuar, minimalisht ndodhen në katin e dytë të këtyre ndërtesave dhe e vetmja mënyrë aksesi janë shkallët<sup>12</sup>.

Në zbatim të VKM nr.1503, datë 19.11.2008, “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”, duhej që të ndërtohej ashensor sipas parametrave të përcaktuara në këtë rregullore ose të gjendendeshin zgjidhje të tjera më pak të kushtueshme, në mënyrë që mos të kishte mungesë aksesi për shfrytëzim nga ana e personave me aftësi të kufizuar.

Për rrjedhojë personave me aftësi të kufizuar u mohohet e drejta për t’u strehuar në kushte të barabarta me të tjerët, duke mos përmbushur kështu një detyrim ligjor, që banesat e vëna në dispozicion të jenë komode dhe të aksesueshme për ata.

**Banesat sociale në Shkozë, qartësisht nuk kanë siguruar të drejtën e strehimit në mënyrë efektive për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, si pasojë e mosrespektimit të kriterëve ligjore, të përcaktuara në VKM sipërcituar dhe gjithë aktet e tjera ligjore e nënligjore.**

---

<sup>10</sup>Referuar përgjigjes zyrtare të Bashkisë së Tiranës, me shkresën me nr.2891/2 prot., datë 12.02.2016. (miratimi i Listës së Përfituesve të tyre si dhe shpërndarja e tyre ka filluar në vitin 2015),

<sup>11</sup>VKM nr.1503, datë 19.11.2008 (pas 2007-ës).

<sup>12</sup>Referuar verifikimit në terren, të bërë nga inspektorët e Komisionerit.



Aktualisht, nga konstatimet e inspektorëve të Komisionerit të bëra në terren, situata mbetet e njëjtë: banesat janë të papërshtatura dhe të pa aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar.

**Mohimi i strehimit të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar, ka sjellë për pasojë diskriminimin e tyre për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre, pasi i ka vendosur në pozita jo të barabarta me të tjerët, sa i takon gëzimit të kësaj të drejte.**

Personave me aftësi të kufizuar duhet t'u sigurohet e drejta për të pasur një jetesë të pavarur, duke eliminuar pengesat infrastrukturore të cilat i vendosin ata në kushte të pabarabarta në shoqëri. Barrierat infrastrukturore dhe mungesa e përshtatshmërisë së banesave sjell mohimin e së drejtës për t'i gëzuar lirisht këto banesa duke i vendosur personat me aftësi të kufizuar në pozita diskriminuese.

Në kuadrin e përpjekjeve për ndërtimin e shtetit social, është e detyrë e vetë shtetit të rregullojë sistemin e mbrojtjes sociale, duke hartuar dhe zbatuar politikat dhe strategjitë sociale. Në këtë kuptim, ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave, duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cënuar parimin e mosdiskriminimit dhe normat kushtetuese. Në çdo rast, këto rregullime duhet të përputhen me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese dhe me detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Evropiane, që janë barazia, drejtësia sociale, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit<sup>13</sup>.

Mbrojtja sociale e personave me aftësi të kufizuara realizohet përmes dy mekanizmave: së pari, nëpërmjet zbatimit të garancive të shprehura në të drejtat dhe liritë ekonomiko-sociale, të parashikuara në Kreun IV të Kushtetutës dhesë dyti, nëpërmjet përmbushjes së objektivave sociale përmes materializimit të tyre në ligje, në referim të nenit 59 të Kushtetutës.

Përmbajtja e të drejtave ekonomiko-sociale, që për nga natyra janë të drejta pozitive, duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore, si në rastet e invaliditetit.

---

<sup>13</sup>Vendimet nr.34, datë 28.05.2012 dhe nr.37, datë 13.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>14</sup>, në nenin 1, të tij rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë,.....aftësinë e kufizuar, .....ose çdo shkak tjetër” dhe qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, në qasje me sa parashikohet prej tij.

**Referuar sa më sipër:**

- Komisioneri vlerëson për rastin konkret se kategoria e personave me aftësi të kufizuar janë vënë në pozita jo të favorshme dhe të pabarabarta krahasuar me të tjerët, duke iu mohuar atyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë mundësinë e aksesit për shfrytëzimin e këtyre banesave.
- Komisioneri vlerëson dhe rekomandon se Bashkia e Tiranës duhet të zbatojë të gjitha detyrimet ligjore për lehtësimin e kushteve për përshtatshmërinë e banesave sociale për personat me aftësi të kufizuar, përmes hartimit të projekteve të reja për shërbime dhe banesa sociale me qira, ku do të parashikohen me prioritet të gjitha masat dhe kushtet e domosdoshme për t’i bërë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëe, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në nenin 3, pika 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Mohim i një përshtatje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të gjitha të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.*

---

<sup>14</sup>Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Detyrimi i shtetit për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar buron nga Kushtetuta, por rregullat e detajuara të sistemit të mbrojtjes shoqërore nuk përcaktohen nga vetë Kushtetuta, ndaj në këtë drejtim ligjvënësi gëzon diskrecion në përcaktimin e këtyre rregullave.

Dinjteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese<sup>15</sup>. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjtetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjteti i njeriut, si një garanci themelore, që nënkupton jo vetëm plotësimin e kushteve materiale të domosdoshme për ekzistencën fizike (ushqim, veshje, strehim), por edhe të kushteve për një pjesëmarrje minimale në ndërveprimin njerëzor dhe në jetën sociale e më gjerë. Të jetuarit me dinjtet përfshin jo vetëm nevojën e ndërveprimit apo bashkëveprimit në shoqëri, por edhe nevojën për të mos u lënë mënjanë nga shteti. Individët që e kanë të kufizuar aftësinë për të gëzuar plotësisht të drejtat e tyre, si pjesa tjetër e popullsisë, duhet të jenë në vëmendjen e veçantë të ligjvënësit.

Ligjvënësi, në funksion të detyrimit për realizimin e objektivave sociale, duhet të mbajë parasysh nocionin e një bërthame minimale të të drejtave dhe lirive të njeriut, siç është zhvilluar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore<sup>16</sup>. Komiteti ka mbajtur qëndrimin se “*çdo shtet palë ka detyrimin për të respektuar një bërthamë minimale që përmbush nivelin minimal esencial të çdo të drejte*”. Neni 2(1) i Konventës detyron çdo shtet palë të ndërmarrë hapa të nevojshëm, duke shfrytëzuar maksimalisht burimet që ka në dispozicion.

Në rastin në shqyrtim, **ligjvënësi ka përcaktuar se, Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun, pra Bashkitë, janë të detyruara të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.**

**Në këtë kontekst, është detyrim i Bashkisë së Tiranës, të krijojë mundësitë për lehtësimin e kushteve për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale aktuale për personat me aftësi të kufizuar, si dhe të hartojë projekte të reja për shërbime dhe banesa sociale me qira, ku të parashikohen me prioritet të gjitha masat dhe kushtet e**

<sup>15</sup>Në Preambulën e Kushtetutës deklarohej: “*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë*”.

<sup>16</sup>Komiteti për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR) është një organ që monitoron implementimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nga shtetet palë. Ky komitet është krijuar nga rezoluta nr. 1985/17, datë 28 maj 1985, e Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC). Shqipëria është shtet palë i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore që prej datës 4 tetor 1991.

**domosdoshme për t'i bërë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse, për këtë kategori personash.**

**PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), c) nenin 3, pika 7, nenin 7, pika 1, nenin 20, pika 1, germa a) pika 2, germa c), germa d) dhe, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme”, nga ana e Bashkisë së Tiranës, ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuar, përmes vënies në pozita të pabarabarta dhe jo të favorshme krahasuar me të tjerët, duke iu mohuar atyre mundësinë për akses dhe për shfrytëzim të banesave sociale.
2. Bashkia e Tiranës të krijojë mundësitë për lehtësimin e kushteve për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale aktuale për personat me aftësi të kufizuar.
3. Të hartojë projekte të reja për shërbime dhe banesa sociale me qira, ku të parashikohen me prioritet të gjitha masat dhe kushtet e domosdoshme për t'i bërë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Bashkia e Tiranës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat, projektet, strategjinë për personat me aftësi të kufizuar, për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale. (të dërgojë një kopje të aktit)
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: aftësia e kufizuar)  
(fusha: të mira dhe shërbime)